FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

VINAS – C

Tretësirë për injeksion – 500 mg / 5 ml
(Acid askorbik)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:
- Çfarë është Vinas-C dhe përse përdoret
- Përpara se të merrni Vinas-C
- Si ta merrni Vinas-C
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Vinas-C
- Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË VINAS-C DHE PËRSE PËRDORET
Vinas-C përmban si lëndë aktive vitaminë C, e cila është një vitaminë e tretshme në ujë, thelbësore për sintezën e kolagjenit dhe materialit ndërqelizor.
Vinas-C indikohet në: parandalimin dhe trajtimin e skorbutit, trajtimin e situatave që kërkojnë një sasi më të madhe të acidit askorbik, rastet e defiçiencës së rëndë të acidit askorbik ose në rastin kur marrja e tabletave është e vështirë.

Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Vinas-C për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë Vinas-C.

2. PËRPARA SE TË MERRNI VINAS-C
Mos merrni Vinas-C në qoftë se:
- vuani nga mbindjeshmëria ndaj acidit askorbik ose ndaj përbërësve të tjerë të formulës;
- vuani nga hiperoksaluria.

Tregoni kujdes të veçantë me Vinas-C
Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Vinas-C në qoftë se:
- jeni trajtuar për një kohë të gjatë me acid askorbik sepse kjo mund të çojë në një rritje të metabolizmit të barit ("rrethana sistemike") dhe mund të shfaqet skorbuti në periudhën kur marrja e vitaminës C reduktohet në sasi normale;
- keni një predispozitë gjenetike për hemokromatozë, sepse në këtë rast mund të ketë një risk të shtuar të përthithjes më të madhe të hekurit;
- keni pamjaftueshmëri të glukozë-6-fosfat dehidrogjenazës, sepse ekziston risku i hemolizës;
- vuani nga insufiçienca renale, sepse ka rrezik për formim të gurëve në veshka;
- jeni i sëmurë diabetik dhe trajtoheni me doza të larta të vitaminës C sepse mund të merrni rezultate fallse të testit të glukozës në urinë.

Mjeku duhet të mënjanojë administrimin shumë të shpejtë intravenoz.

Marrja e barnave të tjera
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Vinas-C. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Vinas-C në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit. Kini kujdes kur merrni Vinas-C së bashku me:

- 30 mg hekur, sepse vitamina C rrit përthithjen e hekurit nga trakti gastro-intestinal;
- aspirinën ose salicilate të tjerë;
- varfarinën, sepse ndodh një ulje e efektit antikoagulant të kësaj të fundit;
- flufenazinën, sepse marrja e njëkohshme çon në një rënie të përqëndrimit plazmatik të kësaj të fundit;
- deferipronin, desferrioksaminën, sepse marrja e njëkohshme mund të përkeqësoië toksicitetin nga hekuri; gjithashtu acidi askorbik mund të rrisë rrezikun e efekteve kardiovaskulare; pacientëve me funksion normal të zemrës, Vinas-C duhet t'i përshkruhet 1 muaj pas fillimit të desferrioksaminës.
- kontraceptivët oralë që përmbajnë estrogjen, fenfluraminën (frenues i oreksit), fenitoinën, tetraciklinën, sepse nxisin desaturimin e indeve nga acidi askorbik;
- antiacidët që kanë përmbajtje alumini, sepse shkaktohet rritja e nivelit të aluminit në gjak e cila mund të çojë në encefalopati potencialisht fatale në pacientët me insufiçiencë renale.

Marrja e Vinas-C me ushqim dhe pije
Mos konsumoni alkool dhe cigare gjatë kohës që përdorni Vinas-C.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji
Këshillohuni me mjekun nëse jeni shtatzënë, planifikoni një shtatzëni apo ushqeni fëmijën me gji.
Ky bar e kalon placentën.
Acidi askorbik në doza më të mëdha se 1 g në ditë nuk duhet të merret gjatë shtatzënisë sepse efekti i dozave të mëdha në fetus nuk dihet.
Vitamina C ekskretohet në qumështin e gjirit, por nuk ka të dhëna për ndonjë rrezik tek foshnjet.

Informacione të rëndësishme për disa nga lëndët ndihmëse të Vinas-C
Tretësira për injeksion Vinas-C përmban:
- metabisulfit natriumi, i cili rrallë mund të shkaktojë reaksione mbindjeshmërie të rënda dhe bronkospazma;
- afërsisht 75.7 mg natrium (përbërësi kryesor në kripën e gatimit) në çdo ampulë 5 ml, e cila është e barasvlefshme me rreth 3.8% të dozës ditore të rekomanduar për të rriturit.

3. SI TA MERRNI VINAS-C
Vinas-C tretësirë për injeksion administrohet nga mjeku.
Mjeku do të përcaktojë dozën e përshtatshme për ju.

Të rriturit: 0.5 g deri në 1 g në ditë në trajtimin e skorbutit, 200 mg deri në 500 mg në ditë për terapi parandaluese.
Fëmijët: 100 mg deri në 300 mg në ditë për qëllime kuruese, ose 30 mg në ditë për terapi mbrojtëse.
Të moshuarit: nuk sugjerohen dozime specifike.

Në qoftë se keni marrë më shumë Vinas-C
Ky bar do ju administrohet në spital, ndaj nuk ka shumë gjasa që të ndodhë mbidozim, gjithsesi njoftoni menjëherë mjekun nëse mendoni se keni marrë një dozë më të lartë se ajo që duhet. Dozat e larta mund të shkaktojnë diarre dhe formim të gurëve në veshka nëse urina është acide. Acidifikimi i urinës në rastin e marrjes së dozave të larta të acidit askorbik mund të përndryshojë ekskretimin e barnave të tjera. Dozat prej 600 mg ose më shumë në ditë kanë veprim diuretik.
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME
Si të gjitha barnat e tjera, Vinas-C mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Vinas-C tolerohet mirë në dozat e rekomanduara.
Njoftoni mjekun tuaj për efektet anësore të mëposhtme që mund t'ju shfaqen:
- çrregullime gastrointestinale të tilla si: diarrea;
- hiperoksaluri dhe formim i gurëve në veshka si rezultat i precipitimit të oksalateve të kalciumit;
- urinim i shtuar;
- tolerancë ndaj barit si rezultat i trajtimit për një kohë të gjatë me të;
- hemolizë në qoftë se vuani nga pamjaftueshmëria e glukozë-6-fosfat dehidrogjenazës;
- dhimbje të lehta të përkohshme mund të ndodhin në vendin e injektimit; administrimi shumë i shpejtë intravenoz i tretësirës mund të shkaktojë marrje mendsh ose gjendje debulese kalimtare.

Për shkak se acidi askorbik është një agjent i fuqishëm reduktues, ai interferon me testet laboratorike që përfshijnë reaksionet e oksidimit dhe ato të reduktimit. Mund të dalin rezultate fals-negative të analizave të plazmës, feçeve ose mostrave të urinës që varen nga faktorë të tillë si: doza e acidit askorbik dhe metodat specifike të përdorura.

Kur shfaqet ndonjë nga efektet anësore të mësipërme, mjekimi me Vinas-C duhet ndërprerë dhe ju duhet të këshilloheni me mjekun për vazhdimin e trajtimit.
Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI VINAS-C
Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Vinas-C pas datës së skadencës të shënuar në paketim.
Ruajeni nën temperaturën 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM
Çfarë përmban Vinas-C Tretësirë për injeksion
Lënda aktive është acid askorbik.
Çdo ampulë 5 ml përmban 500 mg acid askorbik.
Përbërës të tjerë: metabisulfit natriumi, bikarbonat natriumi, EDTA-dinatriumi, ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me 10 ampula.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Janar 2024.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.